IMPRESUM

U N I V E R S I T A S

Revistë për Shoqëri, Shkencë dhe Kulturë

A Periodical for Society, Science and Culture

Botues: FORUM-i për Shoqëri, Shkencë dhe Kulturë "UNIVERSITAS" - Tetovë
Publisher: FORUM for Society, Science and Culture "UNIVERSITAS" - Tetova

Kryeredaktor / Editor in Chief
Izer MAKSUTI

Redaktorë / Editors:
Nuri BEXHETI
Ylber SELA
Vesel MEMEDI
Bardhyl SELIMI

Këshilli botues / Editorial board
Albert RAMAJ (St. Gallen), Bejtulla DESTANI (Londër), Thede KAHL (Vjenë)

Lektor
Jakup MAKSUTI

Design
Dashmir ADEMI

E shtypi / Printed by
ArbëriaDesign, Tetovë

Adresa / Address
Radovan Coniq 11, 1200 Tetovë

E-mail
r_universitas@yahoo.com

Website
http://forumi-universitas.org/

Xhirollogaria / Account number: 200001101255833, Stopanska banka, A.D. Skopje

Numri tatimor: 4028004140962

Revista është e regjistruar në regjistrin e revistave në Agjencinë për Informata me numrin 02-511/I

Ballina / Front Page
Ura e Gurit në Shkup / Stone Bridge in Skopje

© UNIVERSITAS, Tetovë / Tetovo 2006

ISSN 1727-0138

Albert RAMAJ [1]

Shpëtimi i hebrenjve në Shqipëri dhe në Kosovë

Abstract

Hebrenjët në Shqipëri e Kosovë kanë lënë gjurmë të mëdha gjatë tërë historisë shqiptare. Shumë gjëra edhe nuk i kemi parasysh që kanë të bëjnë me hebrenjët. Në këtë shkrim që prezentohet historia e hebrenjëve tek shqitparët, sidomos është e theksuar koha gjatë Luftës së Dytë Botërore, ku hebrenjët kishin kërkuar strehim në Shqipëri për t'i shpëtuar holocaustit. Shpëtimi i hebrenjëve në Shipëri është pjesa e historisë shqitpare që me të vërtetë lavdërohet nga shumë studiues të huaj dhe vet hebrenjët që ende janë gjallë.

Në Shqipëri janë strehuar nga shqitparët dhe kanë shpëtuar të gjithë hebrenjët, kurse historia e hebrenjëve në Kosovë është më ndryshe prej asaj në Shqipëri. SS Divizioni „Skenderbeu" ishte përbërë nga shqitparët dhe për fat të keq ishin kolaboratorë të naziztëve. Këtij shkrimi i është bashkangjitur edhe bibliografia (përgatitur nga Albert Ramaj & Shaban Sinani) lidhur me hebrenjtë në Shqipëri e Kosovë, që botohet për të parën herë.

Gjurmët e para në trojet shqiptare

Prej shekullit të shtatë pas Krishtit mund të gjenden gjurmët e hebrenjve në Shqipëri. Këtë ka argumentuar edhe hulumtimi që ishte bërë para dy vitesh në Sarandë. Sipas dy profesorëve hulumtues nga Izraeli: Ehyd Netzer e Gideon Foerster më 2003, në bashkëpunim me Institutin Arkeologjik në Tiranë në krye me prof. Muzafer Korkutin, erdhën deri te përfundimi se bazilika e Sarandës, e ndërtuar në shekullin VI, më parë ishte një sinagogë. Duhet të theksojmë se në rajon ka gjurmë edhe më të hershme të pranisë së hebrenjve, sikur që është sinagoga në Shtip (sot Maqedoni), që daton prej shekullit II, si dhe disa monumente mbivarrore të shekullit IV të hebrenjve në Mal të Zi. Këtu kemi të bëjmë me hebrenj që quhen "romaniot", që ishin në këto troje në atë kohë. Në Shkup është ndërtuar sinagoga qysh në vititn 1361, në Durrës ka shenja të popullimit të hebrenjve qysh në vitin 1281 dhe në Kosovë qysh më 1442 janë të argumentuara gjurmët, sikur ato në Novobërdë. Kurse në Shqipërinë e Jugut, pikërisht në Janinë, mund të gjinden shenjat e popullatës hebraike qysh në shekullin e XII. Ardhacakët e parë

1 Albert Ramaj është magjistër i filozofisë dhe i teologjisë; ka studiuar në Zagreb, Grac, Vjenë, Zürich. Është autor i shumë shkrimeve të ndryshme shkencore. Tani është drejtor i Institutit shqiptar në St. Gallen, Zvicër.

hebrenj, që i cekëm deri më tani, duhet të kishin ardhur nga bashkësia e vjetër hebraike e Selanikut.[2] Sipas Autorit Jonah von Tudela (vdiq më 1173), i cili shkruan për hebrenjtë e Janinës se ata nuk janë sikur besimtarët nazareas, por bartin emra hebrenj dhe thonë se janë hebrenj.[3] Judenjtë sefarikë apo spanilitët kishin ardhur në territorin e Perandorisë Otomane nga ishilli iberik në vitin 1492 dhe në fillim të shekullit XVI. Përmes qyteteve bregdetare Durrës dhe Vlorë, ata erdhën edhe në Berat dhe Elbasan. Ata kanë lënë edhe gjurmë arkeologjike dhe historike në këto vende. Sipas autorit Schukalla, është më se i sigurt se politika antihebreje e Papës Palit IV (1555-1565) i detyroi ata të gjenin vendstrehim në Shqipëri.

Sabbatai Zevi dhe dorëshkrime të Thora-s

"Pseudomesia" mistik i hebrenjve, Sabbatai Zevi, kishte kaluar ditët e fundit të jetës së vet në Shqipëri. Ai kishte jetuar në ekzil në Ulqin dhe Elbasan. Ka dy teori për varrin e tij, njëra thotë se është i varrosur në Berat, kurse tjetra thotë se eshtrat e tij pushojnë në Ulqin. Ai ka vdekur më 1673 në Ulqin dhe varri i tij është aty, e jo në Elbasan.

Është me rëndësi të theksohet se kishte disa dorëshkrime jashtëzakonisht të vlefshme në Vlorë, që ishin ruajtur më shumë se 500 vite, deri në vitin 1930, kur ato pa kurrfarë gjurme dhe në mënyrë tinzare u shmangën nga Shqipëria[4]. Këto dorëshkrime ishin pjesë të Thora-s, konkretisht „Sefar Thora". Vlora, gjatë viteve 1519-1520, ishte bërë një lloj qendre në rajon. Kështu, në vitet e lartpërmendura, në Vlorë kishte 609 shtëpi të hebrenjve[5]. Sinagoga ishte deri gjatë Luftës së Parë Botërore, kur edhe u shkatërrua.

Më 1910, xhonturqit bënë një regjistrim të popullatës në vilajetin e Janinës. Në bazë të këtij regjistrimi, në këtë vilajet jetonin 5077 hebrenj, në Manastir 6497, në Kosovë 3171. Bashkësitë më të mëdha hebraike ishin në Manastir, me 6435 frymë, Janinë me 4373, Shkup me 2327 dhe Prevezë me 431 hebrenj. Të gjitha këto vende ishin jashtë kufijve të shtetit të Shqipërisë së sotme.[6] Në vitit 1930 në Shqipëri është bërë regjistrimi i popullsisë dhe zyrtarisht, këtë vit, ishin të deklaruar vetëm 204 hebrenj. Bashkësitë hebraike janë të njohura zyrtarisht si bashkësi në Shqipëri, më 2 prill 1937.[7]

Personalitetet hebraike për kulturën shqiptare

Kishte disa personalitete hebraike që i kishin shërbyer kulturës, politikës dhe

2 Krah SCHUKALLA K.J., Nationale Minderheiten in Albanien...f. 514.
3 Krah. ELSIE R., Handbuch zur albanischen Volkskultur... fq. 111.
4 SINANI, in Gazeta Shqiptare 26 Januar 2004.
5 Krah ELSIE R., Handbuch zur albanischen Volkskultur... S. 112.
6 Shif SCHUKALLA K.J., Nationale Minderheiten in Albanien...S. 515.
7 ELSIE R., Handbuch zur albanischen Volkskultur... S. 112.

jetës publike shqiptare, siç është rasti i Aleksandër Moisiu, aktorit të njohur vienez, që luajti në Burgtheater të Vjenës. Duhet cekur këtu se edhe presidenti i sotëm i Shqipërisë, Alfred Moisiu është po ashtu i të njëjtës familje Moisiu, sikur kushëriri i tij Aleksandri, kështu që, rrjedhimisht, edhe presidenti Moisiu është me prejardhje hebraike. Aktori i njohur i filmit gjermano-austriak „Kommisar Rex“ Gideon Burkhard është stërnipi i Aleksandër Moisiut, kështu që edhe ai është me prejardhje hebreje.

Pas proklamimit të pavarsisë së shtetit shqitar më 12 nëntor 1912 u emëruan edhe ministrat në postet e tyre. Një prej tyre ishte hebre, pra ministri i Postës dhe telegrafisë (PTT) Lef Nosi ishte me besim ortodoks, kurse me përkatësi nacionale ishte hebre. Familarët e tij ende jetojnë edhe sot në Tiranë sikur Skënder Kosturi.

Milan Sufflay ishte hebre nga Kroacia. Ai ishte një ndër njohësit më të mirë i të gjitha kohërave i historisë mesjetare shqiptare. Ai kishte publikuar disa vepra dhe shumë artikuj (edhe një roman) mbi historinë e mesjetës shqiptare. Ndër veprat kryesore të tij janë edhe “Acta Albaniae I, II”. Kurse “Acta Albaniae III” dëshironte ta kryente, por nuk ia lejonin kushtet financiare. Parlamenti shqiptar, duke vlerësuar veprat e Milan Schuflay-t, e ndihmoi financiarisht atë. Më 1930 Parlamenti ia deponoi 75.000 franga ari Schuflay-t në një konto private te Banque Commerciale de Bale a Zürich të Zvicrës[8]. Vlera e sotme e kësaj shume duhet të jetë rreth 3 milionë euro. Pas pak kohe, Shufflay vritet nga nacionalistët serbë në Zagreb, kështu që këto para mbetën edhe sot e kësaj ditë në këtë bankë dhe nuk iu kthyen Shqipërisë.

Nuk duhet lënë anësh as Leo Freundlich me veprën e tij që tërë botës ia bëri të ditur për gjendjen e rëndë të popullit shqiptar më 1912-13, që e botoi në Vjenë me titull “Albaniens Golgotha”[9] (Golgota shqiptare). Ai ishte po ashtu hebre.

Këtu duhet të përmendim edhe përkthyesin e njohur Robert Shvarc (Robert Schwarz), që jetoi në Shqipëri dhe me veprat e tij të përkthyera në gjuhën shqipe dha një kontribut jashtëzakonisht të madh për kulturën shqiptare.

Albanologu hebre Norbert Jokl

Kishte hulumtues shumë të njohur, që kishin prejardhje hebraike dhe që kishin kontribuar shumë për historinë, kulturën, politikën dhe në përgjithësi për popullin shqiptar. Duhet të cekim së pari Norbert Jokl nga Vjena. Ai ishte shkencëtar i kalibrit të lartë dhe ishte hebre. Më 1942 gestapot e morën Joklin dhe e dërguan në ndonjë kamp të përqendrimit, kështu që as sot e kësaj dite nuk dihet fati i tij

8 RAMAJ A. DIE RETTUNG DER JUDEN IN ALBANIEN, G2W – Zürich (Ökumenisches Forum für Religion und Gesellschaft in Ost und West) 2/2007 35. Jahrgang, f. 17.

9 Freundlich . Leo, Albaniens Golgatha. Anklageakten gegen die Vernichter des Albanervolkes. Verlag der Buch- und Kunstdrukerei Josef Roller & Co, Vjenë 1913

se si kishte përfunduar. Me vete Jokli kishte marrë edhe manuskriptin e fjalorit të posapërfunduar etimologjik të gjuhës shqipe, një punë me shumë vlerë që u zhduk përgjithmonë. Por ai kishte lënë një bibliotekë shumë të pasur dhe ia kishte falur shtetit shqiptar, por Austria nuk e lejoi deri më sot këtë transfer dhe ende austriakët heshtin.[10] Në një letër edhe Atë Gjergj Fishta kishte kërkuar nga F. Jacomin që Jokl të vinte në Shqipëri. Ai shkruan më 1939 kështu:

"Shkodër, 23 shtator 1939

Shkëlqesisë së tij Françesko Jakomonit Mëkëmbësit Tiranë

Shkëlqesi

Duke marrë parasysh se më i miri filolog i gjallë i gjuhës shqipe në Evropë, është profesor Norbert Jokl me kombësi hebreje, i cili para Aushvicit ishte bibliotekan i Universitetit të Vjenës dhe profesor i Filologjisë në të njëjtin universitet, tani më shkruajnë nga Vjena se autoritetet lokale kanë njoftuar për këtë albanolog të shquar, të largohet brenda 30 ditëve nga territori i Rajhut. Ai është tashmë i pamartuar dhe me një fat të përulur. Për këtë, natyrisht, duhet bërë më e mira, për t'i gjetur një vend, kudo qoftë, sa për të jetuar. Duket se dëshiron të transferohet në Amerikë. Shkëlqesi, pa dyshim që do të ishte një fatkeqësi e rëndë për gjuhën kombëtare shqiptare që ky dijetar, me famë evropiane – të cilin unë e njoh mirë dhe që me autoritetin e padiskutueshëm ka mbajtur gjallë interesin e më të shquarve filologë për gjuhën shqipe, që ta lë Evropën nga zori.

Gjithë kombi shqiptar do t'ju ishte borxhli pamasë nëse V. E. do mundej të gjente shtegun, për ta sjellë në Shqipëri, për t'i atribuar, një detyrë, megjithëse jo fort të shpërblyer, në krahasim me famën e tij si shkencëtar dhe filolog fisnik.

Me bindje të plotë se do ta gjykoni me interesim të njerëzishëm këtë propozim timin – që unë e ndiej për ta çuar përpara, në emër të gjithë intelektualëve shqiptarë, gjej këtë rast për t'Ju lutur të pranoni ndjenjat e stimës sime më të vërtetë dhe mirënjohjes së thellë.

Besimtar i devotshëm Atë Gjergj Fishta"[11]

10 Shih më gjërsisht Albert Ramaj: Jüdischer Albanologe. Norbert Jokl, in: G2W – Zürich 2/2007, f. 24-25.

11 Elsa Demo,Dy lutje të Fishtës, krerëve të fashizmit, në: Shekulli 29.08.2006

Edhe Lasgush Poredeci shkruajti më 22.05. 1938 për problemin e Joklit dhe ardhjen e tij në "atdheun e tij të dytë", siç e quan ai dhe Poradeci shkruan kështu:

„Ngjarjet e fundit gjermano-austriake, si përfundim i të cilave pat qenë aneksimi i pritur i Austrisë nga ana e Reich-ut [Gjermanisë], solli me vete një tok ndryshimesh politike dhe shoqërore, midis këtyre të fundit përjashtimin e elementit izraelit nga fusha e jetës gjermane përgjithërisht. Parimi i Hitlerit, ashtu sikundër parashtrohet prej tij në "Mein Kampf" dhe po zbatohet me paravendim të prerë që prej ditës së ardhjes në fuqi të udhëheqësit të Gjermanisë, nuk njeh dhè tashti, me aneksimin e Austrisë, asnjë ndalim: edhe hebrenjtë austriakë duhet të ndjekin fatin, me fjalë të tjera fatkeqësinë e atyre të Gjermanisë vetë. Ata duhet të emigrojnë, të ikin. Të ikin me hir e pa hir, sa më parë, aq më mirë.

Në bashkëkeqardhjen e njerëzimit përpara këtij fakti të pandalueshëm merr pjesë për veten e tij, një pjesëmarrje të mbushur plot dhembje dhe dashuri dhe nderim mirënjohjeje, gjithë populli shqiptar, në krye me Qeverinë, sepse fatkeqësia e izraelitëve të Austrisë godet kësaj here [shprehje e palexueshme] shumë dhe pa mëshirë një nga fytyrat më të [dashura dhe më] të veneruara të luftës së pavarësisë [së popullit] shqiptar, profesor Norbert Joklin të Universitetit të [Vienës, një albanolog i] madh i ditëve tona.

Në problemin e [shprehje e palexueshme] dhe të dëshprueshëm të lëvizjes shqiptare për pavarësi, në triumfin e gjithëpritur të aspiratave tona kombëtare, një rol kryesor përkrah me përpjekjet politike dhe kulturale, ka luajtur veprimi shkencor i albanologjisë, rrahja, me objektivitet dhe dashuri, e fenomeneve gjuhësore dhe etnologjike mbi Shqipërinë prej savantëve [dijetarëve] të huaj. Sikundër njohja e Greqisë së vjetër, njohje e ndërmjetësuar nga vëzhgues të palodhur, e rriti simpatinë dhe pasuesit [dhe] ndihmën evropiane në epokën e çlirimit të Greqisë prej zgjedhës së huaj, ashtu dhe veprimi i shumanshëm i kërkimeve dhe studimeve të albanologjisë kontribuoi në mënyrën më pozitive për zgjidhjen e favorëshme, prej të fuqishmëve të botës, që iu bë problemit të pavarësisë shqiptare. Prej Hahn-it teri te Bopp-i, prej Meyer-it deri te Weigand-i dhe te Jokli, përpjekja indirekte e jona për të dalë në dritën e lakmuar të lirisë paraqit gjithë aq aspekte, sa revendikimet dhe kombinimet e vështira midis kancelarive zotëruese….

Jo, Shqipëria nuk e la mënjanë me mospërfillje mirëbërësin fisnik të rritjes së emrit të saj në botën e kulturuar, nuk mund ta lë tashti, pikërisht tashti, kur ai gjendet në dispozicion të lirë, gati për t'i shërbyer si gjithnjë Shqipërisë, Atdheut të tij të dytë 9 [Fjalia është shkruar mbi një frazë të

fshirë, ku kuptohet se përsëri është ripërmendur rreziku që i pret izraelitët me ngjarjet austro-gjermane]. Nuk e harron, sikundër ai gjithë Atë [Shqipërinë], një jetë të tërë, jetën e çmuar të djalërisë, burrërisë dhe pleqërisë së tij, ka pasur ndërmend, gjithë për të drejtën, për nderin, për fatin e saj ka derdhur zellin e vëzhgimtarisë së tij të papërtueshme, në librat e tij shkencore, në periodiket e specialitetit, në leksionet enciklopedike, nër broshurat, revistat dhe fletoret shqiptare, duke i mbushur të gjitha me dashurinë e shumtë për vendin e shqipes, Atdheun shpirtëror të mundimeve të tij.

Dhe profesor Jokli nuk vjen kësaj here në Shqipëri, ashtu, me duar zbrazur. Ai sjell me vete, si shenjë nderimi dhe falënderimi, një kanisk [tufë, buqetë] të paçmuar: sjell bibliotekën e tij private të pasur, prej mbi tre mijë volumesh, të gjitha rreth çështjeve dhe problemeve të shkencës së tij [të bukur], në thelbin e së cilës qëndron shkenca e vështirë mbi gjuhën dhe kombin shqiptar, po së cilës ai mundi t'i japë një interes universal të përtëritur. Kështu vjen Dr. Norbert Jokli në Shqipëri, Këshilltar i Oborrit Austriak, Profesor i Universitetit të Vienës, Albanologu më i madh i ditëve tona, kështu e pret Shqipëria, me përulje nderimesh dhe shpërblimesh lëndore, por kryelartë për dashurinë mirënjohëse që i ruan në zemrën e saj".[12]

Është shumë e vërtetë se bibliotekën e vet Norbert Jokl ia kishte falur shtetit shqiptar dhe sot e kësaj dite ajo biblioketë është në Vjenë, pjesërisht në bibliotekën nacionale austriake, e pjesërisht në biblioketën universitare. Ka pra dëshmi për këtë punë, por shteti shqiptar nuk është kujdesur kurrë më pas vitit 1990 për gjëra të tilla.[13]

Hebrenjtë në Shqipëri dhe rrëfimet e tyre për Luftën e Dytë Botërore në Shqipëri

Disa vende të Evropës qysh më 1933 kishin ligje antisemite. Shqipëria po ashtu e kishte një ligj të tillë, por autoritetet dhe populli shqiptar nuk e vuri në veprim atë. Ky ligj ishte diçka në lidhje me udhëtimin e hebrenjve nga vendet tjera në Shqipëri. Shqipëria, siç u dëshmua më vonë, ishte një vend ku hebrenjtë mund të gjenin strehim të sigurt.[14] Asnjë hebre vendor në Shqipëri nuk iu dorëzua autoriteteve naziste, porse kishte shumë prej tyre që kishin ardhur për t'u strehuar nga vendet e tjera të Evropës. Autorë të ndryshëm e kanë hulumtuar këtë fenomen dhe i kanë kërkuar shkaqet dhe arsyet e një fenomeni të këtillë. Sipas tyre, kjo

12 Shih Shaban Sinani, Norbert Jokl ose pengu shqiptar i judeofobisë, në: http://www.albanisches-institut.ch/page5.html

13 Shih më shumë: Albert Ramaj, Jüdischer Albanologe: Norbert Jokl, in G2W - Glaube in der 2. Welt (Zürich) nr. 35, 2/2007, fq. 24-25

14 S., Si u strehuan hebrenjtë në Shqipëri gjatë Holokaustit; SCHMIDT-NEKE, M., Albanien-ein sicherer Zufluchtsort?; NEUMANN J., Umweg über Albanien; LIOLIN, A., Of Albanians and Jews; SARNER H., Rescue in Albania.

gjë ka të bëjë me fjalën e dhënë, pra me Besën apo fjalën e dhënë dhe ka të bëjë poashtu me traditën e lartë kanunore. Kanunin e kishte kodifikuar Atë Shtjefën Gjeçovi dhe e kishte publikuar si fejton në revistën françeskane, kurse si vepër është botuar më 1933 pas vrasjes së tij, sepse Gjeçovin e kishin vrarë njerëzit e shërbimit sekret serb më 1929 afër Zymit të Prizrenit. Një hebre që ishte fshehur në një familje në Tiranë, dëshironte në përfundim të luftës t'i jepte para të zotit të shtëpisë për shkak se e kishte mbajtur në shtëpi. Por i zoti i shtëpisë ia ktheu: „Të kam pranuar si mik, ta kam dhënë `besën`, mikut ia japim besën, por besën nuk e shesim me para"[15] Në aspektin politik pse nuk u dorëzuan hebrenjtë në ndonjë kamp të përqendrimit, janë të ndryshme, por mbi të gjitha meritën më të madhe e ka politika e Mbretit të vetëshpallur – Zogut, në Shqipërinë e asaj kohe. Është interesant fakti se ambasada shqiptare në Berlin kishte lëshuar viza deri më 1938 për hebrenjtë që dëshironin të gjenin strehim në Shqipëri. Kjo për vendet evropiane ishte e pamundur të ndodhte në këtë vit diçka e tillë në këtë vit .[16] Kështu, në Shqipëri kishin ardhur hebrenj nga shumë vende, për t'iu shmangur nazistëve. Kishin ardhur nga Gjermania, Austria, Hungaria, Jugosllavia, Rumania, Kroacia, Bullgaria, Egjipti, Anglia, Polonia, Turqia etj. Sipas J. Neumann dëshmon se në Shqipëri njerëzit kishin ardhur në këmbë prej Budapestit për të shpëtuar jetën e vet, sikur që ishte rasti i z. Jacobson.[17]

Kishte edhe hebrenj prominentë që kishin ardhur në Shqipëri, sikur prof. Stanislav Zuber, shkrimtari dr. Leo Mathia apo Joli Jakob. Dr. Finer, profesor në Londër, kishte kërkuar të vinte në Shqipëri, me përcjelljen e John Walter, i biri i drejtorit të gazetës "Times". Qëllimi i ardhjes së tyre ishte që të merrnin më shumë informata për mundësinë e ardhjes së hebrenjve në Shqipëri. Sipas Shaban Sinanit, në këtë kohë duhet ta kishte vizituar Shqipërinë edhe Albert Einstein (Ajnshtajni). Si dëshmi për këto ngjarje në Shqipëri, kohëve të fundit janë shkruar disa libra, siç është libri i Harvey Sarner me titull „Rescue in Albania: One hundred percent of Jews in Albania rescued from Holocaust" (California, 1997). Një libër tjetër është i Johanna Neumann, me titull „Via Albania" në gjuhën angleze, në gjermanisht është e njohur me këtë titull „Umweg über Albanien", në të cilin përshkruhet udhëtimi dhe qëndrimi i saj në Shqipëri, nga Hamburgu i Gjermanisë. Po ashtu janë shumë të vlefshme publikimet e Shaban Sinanit që bëri në mediat shqiptare. Sipas dokumenteve që gjinden në arkivin qendror në Tiranë, asnjë hebre nuk i është dorëzuar nazistëve dhe nuk është dërgur në kampe të përqendrimit. Pra, strehimi i tyre në Shqipëri ishte vend shumë i sigurt, sidomos deri më 1944.

Samuilo Mandil ishte hebre nga Beogradi dhe kishte ikur gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri ku edhe kishte shpëtuar. Është njëri ndër autorët e parë që

15 Kohl, Christine von: Albanien, München 2003, fq. 71.

16 ELSIE R., Handbuch zur albanischen Volkskultur... S. 112.

17 Neumann, Johanna: Umweg über Albanien. Bochum 2003, fq. 133.

kishte shkruar për temën e shpëtimit të hebrenjve në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ai publikoi artikullin „Izraelitët në Shqipni: para okupacionit, gjatë okupacionit dhe mbas çlirimit nga okupatori“ në gazetën e atëhershme të Tiranës „Bashkimi“ (më 20. II. 1945)[18] Ai kishte ikur më 1992 nga Beogradi në Berat, ku ishte strehuar. Punimi i tij është i pari që trajtoi këtë temë në gjunën shqipe dhe në përgjithësi. Në historiografinë shqiptare është anashkaluar ky shkrim tërësisht, nuk di pse? Mandili përmend një rast shumë intesant se më 1942 janë arrestuar 53 hebrenj në Mitrovicë (Kosovë) dhe u janë dorëzuar nazistëve. Sipas tij, këtë punë e bënë disa renegatë shqiptarë. Ai shkruan kështu: "në atë kohë, në Kosovë, nuk e kishin pushtetin në dorë as Shqiptarët dhe as Serbët vërtetë, por disa renegatë të popullit shqipar, të dejun dhe të helmosur nga propaganda gjermane, kollona e pestë e regjimit fasisht. Kështu mund të kuptohet edhe fakti që në marsin e vj. 1942, autoritetet fashiste të Prishtinës dorëzuan 53 Izraelitë (burra, gra e fëmijë) autoriteteve gjermane të Mitrovicës".[19] Mandili flet poashtu për hebrenjtë tjerë të Jugosllavisë që kishin kërkuar strehim në Shqipëri, sidomos në Kavajë, Shijak, Lushnje e Fier. Hebrenjtë në Shqipëri ishin të sigurt deri më 1943, pra deri me ardhjen e gjermanëve në Shqipëri. Prej 1943 nuk ishin më të sigurt, apo më mirë të themi u shpërndanë nëpër fshatra të ndryshme të Shqipërisë për të kërkuar strehim, sepse në vende apo qytete nazistët bënin kontrolla të ndryshme kur kërkonin të strehuarit, e jo më që ishin nëpër vende të caktuar refugjatësh ku ishin deri më 100 persona me një shtëpi, që në atë kohë quheshin „shtëpi emigrantësh“, që ishin azilkërkues. Fshatarët e Shqipërisë ndanë edhe kafshatën e fundit të bukës së vet për të shpëtuar jetën e ndonjë hebreu nga nazistët.[20] Ky akt nuk ndodhi nëpër Evropë, përpos në Shqipëri. Filmi shqiptaro-gjerman i regjisorit Gjergj Xhuvanit "I dashur armik" (gjermanisht: „Mein Freund der Feind“) i vitit 2003 prezenton po ashtu jetën e përditshme të hebrenjve në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore ku shqiptarët me zemërgjërsi i pritën hebrenjtë në Shqipëri.

Është edhe një gjë shumë interesante që S. Mandil në shkrimin e tij për hebrenjtë në Shqipëri që shkruan se 5 hebrenj ishin vrarë në luftë kundër gjermanëve, pra që iu kishin bashkangjitur partizanëve të Shqipërisë. Ata ishin: Jakov Avramovic, Jusef Konforti, Jusef Bivas, Zhak Ruben dhe David Koen. Mandili nuk cek vendin se ku dhe si ishin vra këta 5 hebrenj. Për këta 5 hebrenj, po ashtu nuk është shkruar në mediat apo shkrimet shqiptare dhe më gjërë, përveç këtij shkrimi të Mandil që është lënë në harresë.

Është interesant fakti se Shqipëria, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore kishte më shumë hebrenj, se sa në fillimin e saj. Hebrenjtë që kishin kërkuar strehim në Shqipëri iu drejtuan edhe Papës Piut XII për, saqë në atë kohë, sipas mundësive kishte ndikuar pozitivisht më shumë se në shumë vende të ndryshme të Evropës.

18 Duke falenderuar Bejtullah Destanin në Londër më ra në dorë ky shkrim.

19 Mandil S „Izraelitët në Shqipni" „Bashkimi“ më 20. II. 1945

20 Krahaso: RAMAJ A. DIE RETTUNG DER JUDEN IN ALBANIEN, G2W – Zürich, f. 19.

Sipas disa autorëve që thonë së një grup prej 400 hebrenjsh nga Dubrovniku i Kroacisë ishin dërguar në kampin famëkeq të Auschwitz, por në fakt këta 400 hebrenj ishin strehuar në Shqipëri, kështu që kishin shpëtuar jetën e vet.

Në Kosovë gjendja ishte pak më ndryshe se në Shqipëri

Në trojet e Kosovës së sotme hebrenjtë ishin qysh më 1442 në Novobërdë afër Prishtinës; gjashtë vite më vonë janë cekur 6 familje hebreje, më 1737 ishin në Gjakovë 600 hebrenj, në Prishtinë rreth 350 hebrenj kishin jetuar ku edhe përmendet një bashkësi hebreje. Duhet cekur faktin se bashkësitë hebraike në Kosovë ishin më shumë të lidhur me popullatën serbe sesa shqiptare dhe këto bashkësi, jo vetëm në Prishtinë por edhe në Prizren apo gjetiu në Kosovë.

Mes viteve 1909 dhe 1912 dëshironin hebrenjtë e Kosovës të shpërnguleshin në Serbi për shkak të luftërave, sepse e ndien vetën të pasigurt në këto troje. Kryerabini nga Beogradi Isaj Alkalaj udhëtoi për në Kosovë për të biseduar me hebrenjtë e atyshëm dhe për t'i bindur që të mos shpërngulen duke i bindur se Perandoria Osmane në Ballkan është duke „perënduar".

Sikur në shumë vende evropiane viteve '30-ta, po ashtu edhe në Jugosllavi ishte aprovuar i ashtuquajtur „ligji rasor" që në fakt kishte të bëjë me hebrenjtë dhe me romët në këtë territor. Kryerabini Alkalaj duhej që të lëshonte paralamentin në Beograd më 1938. Lufta II Botërore shpërtheu gati në të gjitha vendet evropiane, poashtu edhe në Kosovë. Kosova u nda në tri pjesë të okupuara. Italianët kishin Prishtinën, Prizrenin, Pejën, Gjakovën dhe disa vende të tjera. Mitrovica, Trepça e Podujeva ishte nën okupimin gjerman, kurse Gjilani, Vitia dhe Kaçaniku ishin nën okupimn bullgar. Pas kapitullimit të Italisë më 8. 9. 1943 këto vende u okupuan nga gjermanët. Është një fakt shumë i vërtetë se populli shqiptar në Kosovë priti okupatorin gjerman sikur „çlirimtar"

Hebrenjtë që më parë kishin jetuar në Kosovë ishin shpërnguluar në Shqipëri duke parë rrezikun e vet. Kurse kishte hebrenj që kishin ardhur nga vendet e ndryshme duke kërkuar strehim në territorin e Kosovës. Ata që kishin mundësi të merrnin dokumente falso për të ikur në Shqipëri, kishin siguruar jetën e vet, kurse ata që nuk kishin siguruar dokumente falso mund të dorëzoheshin në duar të gjermanëve. Hebrenjtë që kishin ardhur në Kosovë ishin nga shumë vende të ndryshmë të vendeve fqinje, por sidomos nga Serbia, Bosnja e Kroacia, por sidomos nga Beogradi. Drejtoresha e arkivit historik të Beogradit dhe historiania nga Beogradi Dr. Branka Prpa potencon se para Luftës së Dytë Botërore në Beograd kishin jetuar 12500 hebrenj, kurse pas luftës ishin vetëm 1500. Shumica prej tyre kanë pësuar në ndonjë kamp të përqendrimit apo edhe kishte prej tyre që kishin kërkuar strehim në Shqipëri, përmes Kosovës kurse është i njohur edhe kampi i përqendrimit në Saimishte dhe në Banjica në Serbi që ishin vrarë diku rreth 100.000 persona, pra hebrenj, romë, sinti etj.

Një rol shumë të rëndësishëm për antisemitizëm në territorin e Serbisë dhe të Kosovës luante edhe organizata „Zbor“ që ishte krijuar nga Dimitrije Lubotić më 1925, veçmas nën gjeneralin Milan Nedić popullata hebreje gjatë Luftës II Botërore kishte vështirësi të mëdha. Poashtu edhe nga regjimi ustash-kroat popullata hebreje nuk ndjehej e sigurit në Kroaci dhe është i njohur kampi i përqendrimit Jasenovac, dhe që njihet sikur „Auschwitz i Ballkanit“ – ku janë të vrarë shumë hebrenj. Në këtë kohë vetëm Shqipëria ishte e sigurt për hebrenjtë. Për këtë arsye shumë hebrenj tentuan që të depërtojnë nga Serbia, Bosnja e Kroacia në territorin e Shqipërisë dhe përmes Kosovës. Për fat të keq hebrenjtë në Kosovë nuk u pritën edhe aq mirë.

Duhet cekur se një rol të rëndësishëm luante SS Waffen Divizion "Hanxhar" që ishte krijuar në Bosnjë më 1943 edhe për situatën e hebrenjve në Kosovë. Në këtë division kishte edhe shumë pjesëmarrës shqiptarë nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia jugore. Për krijimin e divizionit "Hanxhar" kishte ndikuar jo pak myftiu i Jerusalemit Haxhi Mohammed Amin al-Husseini, që dëshironte të krijonte linjën, Shqipëri-Kosovë-Bosnjë. Ai kishte vizituar më 1941 edhe Shqipërinë, ku prej aty kishte bërë edhe një takim me Adolf Hitler më 24 nëntor 1941.[21]

Pasi që Kryemyftiu i Jeruzalemit kishte kontakte të mira me disa shqiptarë nga Kosova, Maqedonia dhe Shqipëria, ishte i mendimit se duhet krijuar një divizion i vetëm shqiptar në Kosovë. Adolf Hitler kishte dhënë leje Heinrich Himmler (me udhëzimet e kryemyftiut të Jerusalemit) për krijimin e një divizioni nazist shqiptar në Kosovë, në shkurt të vitit 1944. Në mars të vitit 1944 kishte vendosur Heinrich Himmler në bashkëpunim me kryemyftiut e Jerusalemit Haxhi Mohammed Amin al-Husseini që të krijonte devizion "shqiptar". Ky divizion krijohet më 17 prill, konkretisht më 1 maj në rajonin e Kosovës dhe Maqedonisë. Ky divizion kishte marrë emrin e heroit kombëtar Skënderbeu dhe zyrtarisht quhej „Waffen Division SS Skanderbeg".

Divizioni „Skënderbeu“[22] ishte përbërë vetëm prej shqiptarëve nga territori i Kosovës dhe i Maqedonisë që ishte themeluar më 1944. Duhet cekur se shumica e personave që kishin vepruar në këtë divizion, më parë ishin në devizionin Waffen SS "Hanxhar" të Bosnjës dhe të Kroacisë, kurse më 1944 ishte krijuar divizioni vetëm me shqiptarë. Njëri nga protagonistët e këtij divizioni ishin Bebri Pejani dhe Xhafer Deva. Bedri Pejani dhe Xhafer Deva ishin antisemitë të njohur të asaj kohe. Divizioni „Skënderbeu" kishte tubuar rreth vetes 6491 vullnetarë shqiptar[23] dhe që kishte për detyrë të luftonin në krah me gjermanët e kjo d.m.th.

21 Shif Klaus-Michael Mallmann, Martin Cüppers: Halbmond und Hakenkreuz. Das Dritte Reich, die Araber und Palästina, Darmstadt 2006, Kurt-Gert Klietmann: Die Waffen – SS. Eine Dokumentation. (shif. fq. 229) Osnabrück 1965.

22 Noel Malcolm, Kosovo. A short story, fq. 309-310

23 Noel Malcolm, Kosovo. A short story. Fq. 309

edhe të dorëzonin hebrenj gjermanëve. Vetëm një një kohë shumë të shkurtër divizioni „Skënderbeu" kishte tubuar në Prishtinë dhe Gjakovë 400 hebrenj prej nga u dërguan në kampin e përqendrimit në Gjermani, në Bergen-Belsen afër Hannover-it ku edhe vdiqën. Sa i përket numrit të personave ka disa mendime. Sipas Dželetović Ivanov ka të bëjë me 400 hebrenj kurse sipas Noel Malcolm ka të bëjë me 281[24] hebrenj që janë dorëzuar në duart e nazistëve gjermanë nga ana e SS Waffen divizionit Skënderbeu. Nga ky divizion në Shkup është krijaur një kamp ku hebrenjtë mbaheshin përkohësisht para se të dërgoheshin në Mauthausen të Austrisë së sotme. Ky divizion ushtroi dhunë edhe kundër romëve e sintëve. Autorët kosovarë në kohën e sotme nuk pranojnë assesi se kishte hebrenj që janë dorëzuar në duart e gjermanëve nga ana e shqiptarëve. Është absurde dhe pa nevojë kjo që ndodh në mediat kosovare, por faktet tregojnë ndryshe. Në shkrimet e tyre pretendojnë edhe sot pa nevojë të „fshehin" dorëzimin e hebrenjve në duart e gjermanëve nga ana shqiptare dhe përherë ua „hedhin gurin" serbëve për këtë punë se „ata e bënë" e jo shqiptarët. Nuk duhet harruar edhe publikim e Samuilo Mandil që dëshmon se në Mitrovicë shqiptarët u dorëzuan 53 hebrenj autoriteteve germane. Dorëzimin sipas tij e bënë shqiptarët.

Nuk duhet harruar edhe një se autoritetet lokale shqiptare në Prishtinë siguruan dokumente false për hebrenjtë që kishin ardhur në Kosovë për të ikur në Shqipëri dhe duhet veçuar rastin e sekretarit të bashkisë së Prishtinës Prenk Uli që hebrenjve u siguronte pasaporta apo dokumente udhëtimi false vetëm e vetëm të kalonin në Shqipëri për të siguruar jetën e vet. Isuf Qolja[25] që tashmë është 95 vjeçar tregon se si kishte fshehur të ikurit nga Kosova, familjen e Jakov Asherit në Berat. Po të ishin ndier hebrenjtë e Kosovës të sigurt, sikurisht nuk do të iknin apo tentonin të iknin nga Kosova për në Shqipëri. Kishte edhe raste kur hebrenjtë ishin strehuar në Kosovë, sikur që ishte rasti i familjes në rajonin e Deçanit për të cilin shkruajnë autorët kosovarë.

Kryeministri i atëhershëm shqiptar Mustafa Merlika-Kruja që ishtë në shërbim të italianëve, në raport me hebrenjtë kishte luajtur një rol shumë pozitiv, në përjashtim të politikës së tij diskutabile. Për shpëtimin e hebrenjve nga Kosova ishte po ashtu krah i djathtë dhe segretari i Mustafa Krujës, Engëll Çoba, ndërsa në Prishtinë Prenk Uli. Kështu që me organizimin e tyre arritën që me autobusë të firmës nga Tirana me emrin S.A.T.A t'i shpërngulin hebrenjtë e Kosovës në Shqipëri për t'u siguruar jetën, pasi që kryeministri Kruja kishte parë rrezikun e persekutimit të hebrenjve. Disa prej tyre kanë mundur të shkojnë në Shqipëri, sikur që shkuan në Berat më 1942 rreth 100 persona dhe në Prezë 80 të tjerë. Në korrik të të njëjtit vit po ashtu rreth 100 persona që ishin në "burgun" e Prishtinës arritën të shkonin në Shqipëri.

24 Noel Malcolm, Kosovo. A short story. Fq. 310

25 Z. Plaku, "Hebrenjtë nga Kosova 2 vjet në shtëpinë time, Isuf Qolja", në: Gazeta Shqiptare, 12.III. 2004.

Francesco Jacomoni di San Savino në librin e tij "la Politiea dell'Italia in Albania" shkruan kështu:

